

PROGRAMI KOMBËTAR I DEPISTIMIT
DHE I ZBULIMIT TË HERSHËM TË
NDRYSHIMEVE PARAKANCEROZE, TË
KANCERIT TË ZORRËS SË TRASHË
DHE TË REKTUMIT

Qendra për Menaxhimin e Programeve
Preventive dhe të Ripërtërimit të Shëndetit
Departamenti Svit

Nr. i telefonit: 01 620 45 21

Laboratori Svit

Tehnološki park 24, 1000 Ljubljana

Leja e punës

Ministria e Shëndetësisë, nr:

REZULTATI I LABORATORIT

REZULTATI PËRFUNDIMTAR

Pacienti:

Datëlindja:

Data dhe koha e marrjes së mostrës së feçes:

Data dhe koha e përfundimit të analizës së mostrës së feçes:

Data dhe koha e rezultateve të analizës:

Porositësi: Programi kombëtar i depistimit dhe i zbulimit të hershëm të ndryshimeve parakanceroze, të kancerit të zorrës së trashë dhe të rektumit.

Analiza e feçes:

Analiza	Rezultati	Vlera e limitit për testin e depistimit (Cutoff)	Njësia
F-Hb spec. – mostra I		100,00	ng/mL
F-Hb spec. – mostra II		100,00	ng/mL

Rezultatet u punuan nga:

Vlerësimi:

Rezultati i analizës laboratorike të gjakut okult në feçe është **pozitiv**.

Shefi i laboratorit:

Spomenka Lajtner, univ. inxh. i dipl. i kimisë, spec. med. biokem.

VLERËSIMI

Në laboratorin tonë kemi analizuar të dyja mostrat e arritura të feçes tuaj. Ju informojmë që rezultati i analizës laboratorike të gjakut okult në feçe është **pozitiv**.

Rezultati pozitiv i analizës do të thotë që në mostrat e feçes suaj janë gjetur gjurma gjaku. **Kjo nuk do të thotë ende se keni kancer në zorrën e trashë ose në rektum. Shumica e njerëzve me rezultat pozitiv nuk ka kancer.** Rezultati nënkupton që është e mundur që në zorrët tuaja po ndodhin ndryshime të cilat shkaktojnë gjakosje dhe, për këto arsye, ato duhen analizuar më tej. Që të konstatohet shkaku, duhet bërë kontrolli i zorrës së trashë. Kontrolli më i përshtatshëm është kolonoskopia. Më shumë informacione për të mund të lexoni në materialin bashkangjitur. Kolonoskopia zakonisht mund të bëhet në ambulancë dhe vetëm në raste të veçanta nevojitet shtrimi njëditor në spital.

Përafërsisht tek një e treta e rasteve konstatohet që gjithçka në zorrë është siç duhet dhe se gjakosja ka qenë e rastësishme. Tek më shumë se gjysma e rasteve gjinden rritje lythore në mukozë ose polipe të cilat janë ndryshime parakanceroze. **Kryesisht mjeku gjatë kolonoskopisë mund t'i mënjanojë menjëherë ndryshimet e vogla parakanceroze dhe kështu të parandalojë zhvillimin e kancerit. Tek një përqindje e vogël gjatë kolonoskopisë zbulohen ndryshime të tjera patologjike ose kancer i zorrës ose i rektumit, gjë që kërkon kontrollë të mëtejshme dhe mjekim. Gjithsesi, ju këshillojmë ta bëni kolonoskopinë dhe kështu të mundësoni zbulimin e ndryshimeve të mundshme parakanceroze ose të kancerit mjaft herët, në mënyrë që mjekimi të jetë i suksesshëm.**

Rezultatit ia kemi njoftuar edhe mjekut tuaj personal. **Ju lutemi që me këtë rezultat dhe me shtesat e dhëna, të vizitoheni tek ai, më e vona pas një jave.** Mjeku do t'ju kontrollojë dhe do të konstatojë nëse ekzistojnë pengesa shëndetësore për kontrollin e detajuar të zorrës së trashë – kolonoskopinë. Do të bini dakord për mënyrën më të përshtatshme të kontrollit për ju. **Nëse shëndeti juaj e lejon atë, mjeku do t'ju shkruajë rekomandimin për kolonoskopi dhe recetën për lëndën pastruese të zorrëve Moviprep. Bashkë me ju, do të plotësojë edhe pyetësonin bashkangjitur, të cilin do t'ia dorëzoni mjekut specialist të kolonoskopisë, dhe do t'ju japë të gjitha udhëzimet e duhura.** Ju lutemi që në kolonoskopi të keni me vete të gjitha rezultatet që do t'ju dorëzojë mjeku juaj personal, dhe veçanërisht të rëndësishëm janë rezultatet e kolonoskopisë, nëse keni bërë një të tillë më parë. Nëse mjeku juaj personal vlerëson se, për shkak të gjendjes suaj shëndetësore, kolonoskopia për momentin nuk është e përshtatshme, bashkë me ju duhet të vendosë si të veprohet, dhe krahas kësaj do të jetë e mundur të konsultohet me specialistin për problemet gastrointestinale.

Ju lutemi që menjëherë pas vizitës tek mjeku juaj të na kontaktoni bashkë me infermierën ose vetë në numrin e telefonit 01/620 45 22, nga e hëna deri të premtën, nga ora 9.00 deri në 14.00, pas së cilës do të përcaktojmë kohën dhe vendin më të përshtatshëm për ju për kryerjen e kolonoskopisë. Kolonoskopinë do të mund ta bëni në njërën nga qendrat e autorizuara në Slloveni. Ju lutemi të na kontaktoni edhe pse mjeku juaj personal ka vlerësuar që, për arsye shëndetësore, kolonoskopia për momentin nuk është aq e përshtatshme për ju. Mund të na kontaktoni edhe nëpërmjet postës elektronike në adresën svit@nijz.si ose të na dërgoni faks në numrin 01/620 45 29. Pas kësaj do t'ju dërgojmë njoftimin për ditën dhe kohën e saktë të kontrollit dhe adresën e ambulancës ku do të bëhet kontrolli.

Ju lutemi të na kontaktoni sa më parë që së bashku të përgatisim çdo gjë që nevojitet për kontrollin dhe t'ju shpjegojmë pse në feçen tuaj kemi gjetur gjak.

Duke u kujdesur për shëndetin tuaj, ju përshëndesim përzemërsisht,

Bashkëpunëtorët e Programit Svit